



PROPOZIM

Në bazë të nenit 39.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.31.01.2023, bie këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ORARIT TË MBAJTJES SË MBLEDHJEVE TË RREGULLTA DHE PUBLIKE
TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT DHE MBLEDHJEVE TË RREGULLTA
TË KPF-së PËR VITIN KALENDARIK 2023

Neni 1.

Caktohet orari i mbajtjes së mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit të Komunës së Deçanit, si dhe mbledhjeve të KPF-së për vitin kalendarik 2023.

Neni 2.

Kuvendi i Komunës së Deçanit do të mbajë mbledhjet e rregullta në fund të çdo muaji.

Neni 3.

Kuvendi i Komunës së Deçanit do të mbajë së paku 2(dy) mbledhje publike dhe ato, mbledhja e parë në muajin Qershor dhe mbledhja e dytë në muajin Dhjetor.

Neni 4.

Komiteti për Politikë dhe Financa do të mbajë mbledhjet e veta të rregullta 3 ditë para mbledhjeve të Kuvendit.

Neni 5.

Kuvendi i Komunës dhe Komiteti për Politikë dhe Financa mund të mbajnë edhe mbledhje tjera të rregullta jashtë këtij orari sipas nevojave dhe kërkesave të paraqitura.

Neni 6.

Për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta anëtarët e Kuvendit dhe KPF-së do të njoftohen së paku 7 ditë pune para datës së mbajtjes së mbledhjes, ndërsa mbledhjet publike do të publikohen së paku 2 javë para takimit.

Neni 7.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit dhe Shërbimi Profesional për Punë të Kuvendit dhe Ekzekutivit.

Neni 8.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.I-3

Deçan, dt.31.01.2023

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ